



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ITALIANE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Edukim Ndërkulturor

Ngarkesa: 5 kredite; 60 orë mësimore; 45 leksione / 15 seminare
Viti / Semestri : Viti I, semestri II
Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme
Programi i studimit: Master i Shkencave në “Mësuesi e gjuhës italiane”
Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 90)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore:

Studenti duhet të jetë i aftë: Të ndërgjegjësohet për rëndësinë që ka Edukimi Ndërkulturor në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies; Të përftojë sa më mirë njohuritë e lëndës duke ndërvepruar dhe punuar në mënyrë të pavarur; Të thellojë logjikën në perceptimin dhe interpretimin e nocioneve dhe tematikave të ndryshme nëpërmjet të menduarit kritik; Të përçojë tek studenti qytetërimin dhe kulturën e gjuhës që studion nga pikëpamja historike, sociologjike dhe etnografike;

Objektivat specifike lëndore:

Studenti duhet të jetë i aftë:

1. Të njohë sa më mirë çështjet e edukimit ndërkulturor si edhe studjuesit dhe materialet e ofruara për këtë qëllim;
2. Të fitojë kompetencat e duhura gjuhësore dhe kulturore, aq të domosdoshme për formimin e mësuesit të gjuhës italiane;
3. Të përdorë tekste letrare dhe dokumente të tjerë autentike në mënyrë të tillë që të rrisë zotërimin e aftësive themelore të komunikimit: dëgjimin, të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit;
4. Të krijojë portofolin letrar të mësimit të gjuhës dhe të ndërveprimit ndërkulturor

Rezultatet e pritshme:

1. Aftësia për të zbatuar njohuritë e ndryshme gjuhësore, letrare dhe kulturore në procesin e nxënies.
2. Aftësia për analiza gjuhësore, letrare dhe kulturore në kontekstin historik-kulturor.
3. Aftësia për trajtimin e informacionit dhe argumenteve në mënyrë kritike dhe vetë reflektuese, me qëllim vlerësimin dhe respektimin e kulturës së huaj dhe asaj shqiptare;
4. Aftësia për të ushtruar mendime analitike, kritike dhe logjike në interpretimin e dukurive të ndryshme historike, artistike dhe kulturore.